



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DROPULL  
KESHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT-VENDIM**

**NR. DATE 28 /02 /2021**

**PER**

**“MIRATIMIN E RAPORTIT PER VLERESIMET DHE PARASHIKIMET  
AFATMESME TE TE ARDHURAVE, NE KUADER TE PERGATITJES SE P.B.A. 2023-  
2025”.**

Ne mbeshtetje te nenit 41, pikat 1 dhe 2 te ligjit nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, nenit 24 pika 1/b te ligjit 9936, dt.26.06.2008, i ndryshuar, “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, te nenit 33, pikat 1; 2; 3 te ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, Udhezimit nr.23 dt.30.07.2018 “Per procedurat standarte te perгатitjes se programit buxhetor afatmesem te NJ.V.V.”, Vendimit te K.B. nr.70 dt.22.12.2021 “Per miratimin e kalendarit te P.B.A 2023-2025, buxhetit vjetor dhe monitorimit te tij per vitin 2022”, ne mbledhjen e dates 28.02.2020 me propozim te kryetarit te Bashkise,

**KESHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

- 1. Miratimin e raportit per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave , ne kuader te perгатitjes se P.B.A. 2023-2025.(bashkangjitur)**
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes (sipas percaktimeve te nenit 55 ,pika 6 te ligjit nr.139/2015”Per Veteqeverisjen Vendore”).

**KRYETARE  
Donika BAUÇI**



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA DROPULL

### DREJTORIA E TE ARDHURAVE



Nr Prot

Jorgucat,më .01.2022

## **RAPORTI I VLERESIMIT TE TE ARDHURAVE AFATMESME NE KUADRIN E PREGATIJES SE PBA 2023-2025**

Ne mbeshtetje te Udhezimit Nr.22 date 23.7.2018 "Per procedurat Standarte te hartimit te PBA ne njesite e vetqeverisjes vendore",nga ana e Drejtorise se te Ardhurave ju paraqesim raportin e vleresimit te te ardhurave afatmesme qe konsiston ne te dhenat faktike te vitit 2021, ne realizimin e pritshem te vitit 2022 si dhe planifikimet per vitet 2023-2024-2025

Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Planifikimi i te ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Dropull, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Procesi i planifikimit të të ardhurave të veta u realizua në bashkëpunim me administratën e bashkisë. Te dhenat nga secila drejtori te cilat krijojne te ardhura per bashkine duke iu referuar realizimit vjetor, realizimit te dy viteve paraardhese perbejne bazen e perlllogaritjeve. Vazhdimi i këtij procesi bashkëpunues do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e

mëtejshëm te shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë. Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë në pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta janë, taksa e pasurisë së paluajtshme ku përfshihen:- taksa mbi token bujqesore -taksa mbi truallin dhe taksa mbi ndërtesën që rreth 30%, taksa e ndikimit në infrastrukturë që rreth 16%, tarifa për pastrimin që rreth 13% të tij taksa e mjeteve të përdorura që rreth 6%, të ardhura nga dhenie me qira kullota që rreth 12%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 75% të planit të të ardhurave të Bashkisë Dropull. **(bashkengjitur tabela nder vite 2020-2025)**

**Kapacitetet fiskale të taksapaguesve**

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e rregjistrave për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak. Në total kapaciteti i taksapaguesve është parashikuar rreth 5010 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet.

**Taksapaguesit biznese dhe institucione**

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, numri i bizneseve dhe institucioneve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Dropull është 194. Biznesi i vogël që rreth 60% të numrit total të bizneseve.

**Kapaciteti i pronës së taksueshme**

Bazuar në rregjistrat aktual, në total, sipërfaqja ndërtesave që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Dropull është rreth 128022 m<sup>2</sup>. Bizneset prodhuese zënë sipërfaqen më të madhe .

**Detajimi e të ardhurave sipas zërave, pesha tek të ardhurat e bashkisë**

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifat vendore, dhe të ardhurat e tjera. Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve të sipas kriterëve të përcaktuara me ligj. Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në: 1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; 2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ; 3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Dropull "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Dropull

**Te ardhurat nga taksat vendore** Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore,

mbledhjes dhe administrimit e tyre. Për vitet 2023-2025 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë rreth 37% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë. Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 28% të totalit të të ardhurave nga taksat e veta.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat vendore me një rritje prej 1.5% në vit për vitet 2023-2025 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

-saktësimit dhe vlerësimit të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet verifikimeve në terren, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritsëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI etj

**Të ardhurat nga Taksat e Ndara** Të ardhurat nga taksat e ndara bazohen në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 25, Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë: a) 97 % e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë; b) 25 % e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura; c) 5 % e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare; ç) 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Sipas ligjit, të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës. Për vitet 2023-2025 të ardhurat e parashikuara për bashkinë Dropull nga taksat e ndara përbëjnë rreth 9% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

**Te ardhurat nga Tarifate Vendore** Referuar ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifate vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi. Për vitin 2023-2025 të ardhurat e parashikuara nga tarifate përbëjnë rreth 38% të të ardhurave të veta. Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifate vendore e zënë të ardhurat nga tarifate për ofrimin e shërbimeve publike si pastrimi e largimi i mbetjeve me 47% të ardhurave nga tarifate vendore. Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, e cila shpërndahet dhe paguhet nga familjet dhe bizneset si kontribues dhe përfitues të këtij shërbimi.

### **Te ardhura te tjera**

Referuar ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 36, te ardhura nga burime te tjera janë: të ardhurat nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të bashkisë; të ardhurat nga investimet mbi kapitalet; të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia; të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi; të ardhurat nga partneritetet privat-publik, te ardhura nga ndihmat ose donacionet.

Bashkia parashikon të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, shitja e mallrave, interesat, gjobat, dhe ndihmat. Të ardhurat nga burime të tjera përbëjnë në total vetëm 18% të të ardhurave nga burimet e veta vendore. Të ardhura nga shitja e mallrave zene pjesen më të madhe të grupit I të ardhurave të tjera .

Të ardhura nga ndihmat donacionet Referuar Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të pranojnë donacione, të cilat regjistrohen në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Donacionet e pranuar nga institucioni në varësi apo në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të raportohen të ky fundit, në çastin që ato merren. Meqënëse planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marreveshjet për sponsorizime dhe donacione, nuk parashikohen ndër vite të ardhura nga ky zë. (prandaj duket në pasqyre sikur kemi ulje të nivelit të të ardhurave të grupit I të ardhurave të tjera).

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë parashikon mbajtjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe të ardhurat e tjera, falë fokusimit për zgjerimin e vazhdueshëm të bazës taksapaguese dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja) por jo me ndryshime në nivelet e taksave apo tarifave, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitorë, etj. Të ardhurat parashikohet të ruajnë një nivel të arkitimeve, duke siguruar kështu plotësimin buxhetor dhe fluiditetin e nevojshëm financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Në vazhdimësi, përmirësimi i shërbimit ndaj tatimpaguesve si rrjedhojë e shtrirjes në— njësitë administrative shërbimi nga zyrat postare ku paguhen taksat e familjareve për administrimin e taksave dhe tarifave vendore .

**KRYETARI**

**Dhimitraq TOLI**